

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

NDOJ MHILLI, VINÇENS MARKU

ELEMENTET KANUNORE, VENDI DHE FUNKSIONI - LINJA ÇMITIZUESE TEK LOJA E MBASDREKËS

Si fillim e shohim të udhës të shpjegojmë se: “*fjala kanun s’ka dyshim se etimologisht rrjedhë prej fjalë greqishte ekipi qi don me thanë: mastar-njajo vegël e drunit a e ndonji brumit tjetër, qi vjen me tërhjek viza të drejta. Metaforikisht shenjon shtillin e ligjeve gojdhanse e të pakodifikume, mbas të cillave ecte dikur hullija e jetës e e veprimit të popullit shqiptar*”.¹ Ksodore e shpjegon Gj. Fishta fjalën Kanu tek parathanja e veprës (mbledhësi i atyre rregullave kanunorë ndër malësorë të veriut) së Gjeçovit.

Një tjetër shpjegim për fjalën Kanun e ndeshim tek Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe të Gustav Mayer: “*Kanón (kanon) m. “udhëzim, rregull; zakon; ndëshkim fetar. Kanónis “rregulloj, urdhëroj”. Kanún m. “e drejt, rregull”. Kanós “kërcënoj, tremb”. Kanóst ndajf. “kërcënues” kal. Kanosí f. “kërcënim, dënim, gjobë”. Kanosís “dënoj. Nga gr. e re *ῥα νόμος, ῥα νόμος* “regla, penitence; *ῥα νομίζω*. Arum. canonā; turq. kanun, prej nga rrjedh së pari shq. Kanún. Dhe së dyti: “*Kanón (Kanón) m. “top”. Nga it. cannone, gr. e re *ῥα νόμος*, nga canna “gyp”*”.*²

Kanuni - doket, zakonet e malësorëve në dramën *Loja e mbasdrekës* shkelen e thyhen në tre pika themelore, madje shkohet më tej deri te shkelja më e rëndë për traditën etnokulturore të malësorit, thyerja apo shkelja e besës, aq e hyjnizuese dhe e veshur me trajta mitike nga shqiptarët, e cila është pasqyruar edhe në legjendat tona si tek Rozafati (ku besa thyhet e shkelet nga dy vëllezërit më të mëdhenj) dhe ajo e Doruntinës (ku i vdekuri ngrihet nga varri për të mbajtur besën e dhënë).

Më poshtë do të orvatemi të parashtrojmë disa nga elementet që shkelen/thyhen në Kanu nga personazhet/aktantët e dramës *Loja e mbasdrekës* dhe do të rrekemi t’i analizojmë ato sipas ligjësive të shkelura - shpërfillura aty:


1. Shkelja e besës
2. Pritet miku (vrasja në drekë, i priten miqtë jo vetëm shtëpiakut që nuk la kënd mbrapa, pra fisit të tij deri tek prijësi i fisit - flamurtari).
3. Pirja e verës në drekën mortore - shkelet zakoni e doket malësore të ceremonisë së drekës - mortit.
4. Vrasja në moh - në pabesi e Zekës.

¹ Atë Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shtypshkronja “GEER” Tiranë, 1999, f. 25.

² G. Meyer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe 1981*. Përktheu: Anila Omar, Botime Çabej, 2007, f. 226.

5. Beja që bën mjeku - si pjesë e traditës dhe jo si shkelje zakonore, sepse ai tregon/pohon të vërtetën.

6. Amaneti që lë Përtej Drinasi që në drekë të tij të qitet mish, verë e raki - si brum/tharm i traditës së lashtë etnokulturore të malësorit, pra ligjet e pashkruara. (Ligjet e pashkruara bëhen cytëse për shkeljen e ligjesisë Kanunore, apo më mirë të themi shërbejnë për të përligjur shkeljen e bërë. Respektimi i vullnetit - amanetit të të vdekurit çon në një konflikt të pashembullt. Pra nga kjo del se kur përballen ligjet e pashkruara me ligjet e shkruara dhe të kodifikuara nga shoqëritë njerëzore - Kanuni dhe Ligji zbehen që të tre dhe pjellin zezona. Në tekst kemi një triptik përballjeje: ligjet e pashkruara si përfaqësues të lashtësisë, ligji i kodifikuar - shkruar Kanuni si përfaqësues i kohëve më të vonshme - mesjetare dhe Ligji - institucioni shtetëror si përfaqësues i kohëve të sotme. Secili prej tyre përfaqëson një nivel të ri organizimi në shoqëritë përkatëse. Përzjerja apo përdorimi i tyre në struktura të reja shoqërore çon në shpërbërje, konflikt dhe degradim të secilit prej tyre. Nga kjo na rezulton se tek *Loja e mbasdrekës* përballen konfliktueshëm tri nivele të ndryshme të organizimit të shoqërisë njerëzore; aty dualizohen edhe tre periudha të ndryshme kohore, duke filluar tek prehistorikja, mesjetarja e duke përfunduar tek bashkëkohorja/modernia - e sotmja. Periudhat e ndryshme historike në mënyrë simetrike dualizojnë njëra-tjetrën).



7. Dashuria e ndaluar me Bjeshkën, kur ajo kishte qenë vajzë, e cila i hedh armën Zekës në zezonën e Përronit të Mbylltë.

8. Prishja e mortit.

Lipset të shpjegohet se çfarë kuptojmë me fjalën besë, e cila shpjegohet kështu në Fjalori i gjuhës shqipe: “Besë fjalë e dhënë për diçka të rëndësishme, premtim që jepet me dëshirë dhe me sigurinë se do të mbahet, fjalë e nderit për t’u plotësuar medoemos, një detyrim që merret për sipër; besa e burrit, i jep besën, besa e burrit si-sa pesha e gurit etj”.

Ndërsa më poshtë jepet edhe një shpjegim tjetër: “Zotim që shpija e të vramit i jepte vrasësit ose familjes së tij, që brenda një afati të caktuar kohorë të mos e merrte gjakun prej tyre; prishi besën, e vrau në besë”.

Mendojmë se për studimin tonë është me vend të jepet edhe përcaktimi i kësaj fjale/nocioni në *Kanunin e Lek Dukagjinit* në nenin - nye njëqindenjizetedytë pikat 854, 855, 856 e kanunit fjala besë:

Pika 854. Besa asht një vend liriye e sigurimi, qi shpia e të vramit i ep dorërasit e shpijarvet të tij, tuj mos i ndjek për gjak përkohësisht e mje në vade të caktueme.

Pika 855. Me çue gjind për besë asht kanu; me dhanë besë asht detyrë e burrni.

Pika 856. Shpija e të vramit po i dha besë dorërasit, ky edhe pse e vrau, do të shkojë në mortë e në gjamë me percjellë të vramin derti në vorrim e me ndej per drek.-kjo besë ngjatë 24 orë.³

Besa në Kanu ka dy nene - nyje (siç i emërton autori Gjeçovi) dhe 31 pika që fillojnë nga pika 854-885, pra një përcaktim të thuktë kur e si jepet ajo, por ama për mendimin tonë aty ka diçka e cila duhet shtuar, besa shkon përtej gjakmarrjes, - ajo për malësorët është edhe një fjalë e dhënë për çfarëdo në një rrethanë të caktuar dhe që mbahet e ruhet me kryet e bestarit. Një pikë tjetër që mbetet pa u sqaruar në veprën e Gjeçovit është ndëshkimi që jepet dhe pëson besëshkelësi, megjithëse kjo nuk është objekt i studimit tonë.

Nocioni besë për malësorët në veçanti dhe shqiptarët në përgjithësi ka marrë vetitë e ligjit të pashkruar, i cili ka marr trajta hyjnore dhe mitike, pra duke kaluar nga një gojëdhënë në ligj - kanon - shkrim që merre tipare hyjnore. Po të hedhim sytë edhe në Bibël, në fakt ai që shkel fjalën e dhënë dënohet nga Zoti, për shkeljen e bërë, aq sa ai nuk është i pëlqyem më as para Tij. Besa dhe tradhtia, shkelja e fjalës së dhënë shpesh herë janë parë edhe si dy anë të së njëjtës medalje. Një ndër personazhet më negativ, më të ulët, më të denigruar, më pak i moralshmi të *Dhiatës së Re* është Juda, i cili pat tradhtuar duke e shitur Jezusin tek priftërinjtë për tridhjetë cikla ari, megjithëse Jezusi e paradinte se ai do ta tradhtonte, por ama nga ana tjetër Ai i thotë në darkën e fundit se: “*mjerë ai që do të më tradhtojë se do të ishte më mirë sikur të mos kishte lindur fare*”. Pra, notat hyjnore, fjala e dhënë, besa, i merr për mendimin tim që në Bibël, por ama nuk jam në gjendje të them se si arriti deri në shenjtërim besa ndër shqiptarë. U ndikua nga Bibla apo u shërbente si një domosdoshmëri institucioni i besës, apo ishte natyra që vetvetiu i dha trajta të tilla, e them këtë, sepse po të pyesësh ndër malësorë ata të bien me shembuj konkret se ata që kanë shkelë besën bishtnueshëm edhe kur i kanë shpëtuar ndëshkimit që parasheh Kanuni janë ndëshkuar në mënyrë misterioze nga natyra. Megjithatë duket se një përgjigje për këtë na e jep studiuesi, etnologu Mark Tirta: “*Besa është dukuri universale me natyrë etno-morale dhe etno juridike në jetën e popujve të lashtësisë dhe të bashkësive fshatare gjatë mesjetës. Besa si virtyt moral e ka zanafillën nga lashtësia, para lindjes së shoqërisë së organizuar në shtet e të formacioneve shtetërore, si një mjet i shprehjes së solidaritetit të bashkësisë fisnore. Ajo mbështetet në kultin e fjalës së dhënë, e cila sipas mendësisë së besimeve të lashta, ishte akt hyjnorë i pathyeshëm*”.⁴

Një ndëshkim i tillë ngjet më së shumti për dy elemente që kanë marr trajta hyjnore për besën dhe për benë e bërë në rrenë. Dy sakrilegjet më të mëdha për malësorin janë shkelja e besës dhe bërja be në rrenë, e të cilat sipas malësorëve ndëshkohen nga perëndia, në mos nga njeriu. Besa ndër shqiptarë duket se është një element tepër i hershëm sipas studiuesit Emil Fazhiu: “*Fjala e dhënë solemnisht, besa, ka qenë e njohur dhe e respektuar ndër fiset Ilire. “thuhej se*

³ Atë Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shtypshkronja “GEER” Tiranë, 1999, f. 82.

⁴ M. Tirta, *Etnologjia e shqiptarëve*, Tiranë, 200, f. 337.

*hyjnitë ilire e kishin bekuar besën dhe lidhjen e njerëzve me anën e besës si një akt që lartëson moralisht qenien njerëzore dhe këtë popull, duke e veçuar nga të tjerët, të pabesët”.*⁵

E pamë të nevojshme të bënim këtë parashtrim duke dashur ta bëjmë më të qartë çështjen që po orvatemi të trajtojmë.

Besa - element etnokulturor pjesë e botës etnopsikologjike të Malësive të Veriut dhe më gjerë ndër shqiptar, është materializuar nëpërmjet procesit shkrimor në subjekt letrar. Me gjasë Knuni, doket dhe zakonet, pra ligjet e shkruara dhe të pashkruara i kanë shërbyer autorit si një paratekst, për sendërtimin e strukturës së dramës *Loja e mbasdekës*.

Tek *Loja e mbasdekës* kemi shkelje të besës, sepse gjakësorët vrasin njërit-tjetrit në mortin e Përtej Drinasit, pra jo vetëm që janë miq të premë, por edhe thyjnë besën e zonës, trevës dhe të familjes ku bujnë si mortarë.

Zeka vret në besë mbasi janë rregulluar për të keqen që i ka bërë vëllathi i tij, pra vret probatinin⁶. Kjo është një shkelje fort e rëndë e Kanunit, e në këtë mënyrë Camaj vë në pah thyerjet/shpërfilljet më të turpshme - rënda dhe më domethënëset që i janë bërë. Duke na kumtuar se shpesh Kanuni është zbatuar sa për sy e për faqe, e jo për burrëri e moral të sinqertë, siç më herët vëren Migjeni te *Studenti në shtëpi*. Një shkelje e tillë vërehet në pohimet që bën aktanti gjatë dialogimit:

Mjeku: *Prej dorës sate! Ti ke vra atë ditë, vetëm me një revole, jo vetëm tim at. Gjyqtarit. Ky, përmbys mbas një guri, ka vra tim at, gjyshin e Gjormit; tri herë ka qit edhe në atë që thirrte vëllath deri sa nuk ka luejt vendi ma. Shumica kanë ikë, por, jo, Zeka i tërbuem..*⁷

Thyerja apo shkelja e besës në traditat doket dhe zakonet malësore ishte një ndër sakrilegjet më të mëdha, dhe një shkandull i rëndë dhe i pafalshëm nga fisi, shoqëria e deri tek i prijtësit e fisit - flamurtari. Nëse dikush guxonte të shkelte besën dhe të vriste në pabesi, mbar zona duke i pri i pari i fisit/flamurtari ndërhynte, duke i djeg shpi e katandi e duke e nxjerr prej zonës, ndërsa besëshkelësi hynte në gjak me dorëzanët, me ata që kishin ndërhy tek familja e të vrrarit për me marrë besë.

⁵ E. Fazhiu, *Kanunorja e lëvizjes Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare*, Prishtinë, 2008, f. 3-5.

⁶ Shih: Në nyjen njëqindëkatërdhetet të Kanunit ja se ç’thotë për pajtimin dhe të bamit probatin:

Pika 988. *Si t’u pajtohen zemrat shpijavet të dorërasit e shpis së të vrramit, pijn gjakun e shoqi-shokutë.*

Pika 989. *marrin dy gota të vogla, i mbushin per gjumash me ujë a me raki; qohet ndonji prej dashamirësh e u lidhë dy gishta të vegjel, i shpojn me gjylpanë, tuj ba me lshue ka një pikë gjak veçmas nder dy gota. Atë Sh. Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Vep. e cit., f. 92.*

⁷ M. Camaj, *Drama*, Vep. e cit., f. 94.

Elementet kanunore, vendi dhe funksioni – linja çmitizuese tek *Loja* ...

Prerja e mikut⁸ është një moment tjetër ku shkelen doket dhe zakonet e malësorit. Një gjest i tillë është i paburrërishtëm - i pamoralshëm, por edhe i ndëshkueshëm në Kanu dhe ndër malësorë. Kujt i pritët miku i lindet detyra të marrë gjakun e mikut të premë, e *mikëpremsi* - vrasësi bie dy herë në gjak me familjen dhe fisin e atij që i ka pre mikun dhe me familjen e të vëçarit. Këtë ide e përçon/ilustron më së miri pasazhi:

Mjeku: *Të plagosunit, mandej, janë lëshue njeni kundër tjetrit, tue gjimue si egërsina prej dhimbs së varrëve e acarimit. Këta e vetëm këta, kanë vijue deri në fund gjakmarrjen, edhe ma vonë, deri sa kanë dalë të gjithë fare. Por jo të gjithë! Tue shënue Zeken. Ky ka mbet gjallë me të gjitha ata plumba në korp!*⁹

Ligësia njerëzore dhe barbaria e ngjarjeve të tilla del qartësisht në citimin e më sipërm. Lexuesi - publiku në një performancë skenike është i aftë të rrokë këtë barbari - ligësi që mbart në vetvete qenia njerëzore, e cila na rezulton e zhveshur nga humania. Publiku në sallë apo lexuesi, kur përballët me një përshkrim të tillë që bën aktanti apo që artikulon aktori, menjëherë orvatet të gjejë brenda vetes mekanizmat mbrojtës që e shmangin apo që e shfajësojnë nga një rrethanë/situatë e tillë, në të cilën zhvillohet veprimi dramatik. Vet aktantët mbajnë një qëndrim të distancuar ndaj ngjarjes, duke kërkuar të gjejnë shkaqet e zezonës më së shumti sesa për të dënuar apo shpallur fajtor Zekën.

Prishja e mortit/drekës nga Zeka dhe pjesëmarrësit e tjerë është një tjetër thyerje dhe shkelje e Kanunit siç përcaktohet në krye *njizetekater*:

“Pika 1230. Kanuni i Maleve nuk ban qi t’i shkarkohet kujej trazim mbi trazim.

*Pika 1231. Kur t’i desë kush njëj shpije në katun, per një javë ditë rresht- mbas deket- nuk mund t’i bëzajë kush te dera per kurnji punë, qi t’a ketë vendi me e ba katundisht”.*¹⁰

Pyetja që lind është: përse ndodh një turp - shkelje e tillë? Ndoshta për faktin se Përtej Drinasi nuk lë pasardhës, dhe me djallëzi kishte lënë një amanet i cili bëhet iniciuesi i rreshkatës. Pra, si rrjedhojë nuk ka kush ta mbrojë nderin e

⁸Shih përcaktimet që bën *Kanuni i Lekë Dukagjinit* në neni - nye nandedheteshtatet për mikun dhe të prert e mikut në pikat:

Pika 641. Veç një gacë me t’a lyp kush te dera për me kallë çibukun, i a dhe, e ngau kush, të pritët mik.

Pika 642. Po të ra ndore kush, edhe tuj t’a xanë vetem emnin: “ jam miku i njatij” e edhe pa të pasë kenë kurr te dera, po e ngau kush, të jet mik në derë, e ftyra t’u vrugnue.

Pika 643. Po t’a vuni kush mikun në lojë a t’a shau, ti do t’a mkambish nderen e mikut me rrezik të jetës s’ate.

Pika 644. Po i u pre kujej miku, kanuja i ka lanë dy udhë: a të fiket, a të koritet.

Pika 645. Atij, qi i u pre miku, çdo send do t’i epet me dorë të majtë e per nen giu mje qi t’a paguej mikun.

Pika 646. Dora e majtë me kanu quhet e pandershme, e cilla merr e nuk ep; me miq nuk falet. Veç i pabesi me të pabesin falen me te. At Shtjefën Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Vep. e cit., f. 67.

⁹ M. Camaj, *Drama*. Vep. e cit., f. 95.

¹⁰ Atë Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Vep. e cit., f. 109.

shtëpisë së tij. Një qëndrim i tillë na flet për veprime të paburrërishtme të Zekës dhe gjakësorëve të tjerë, të cilët turpërojnë një shtëpi pazot, duke shkelë një dhimbje solemne, në një mort ku një shtëpi del fare. Sjellja e mortarëve të cilët pinë raki, venë dhe han mish e dehen është në shkelje të ligjësisë dokësore, veprime krejt të turpshme për këta malësorë dhe për sjelljet e tyre të panjerëzishme, të pamoralshme në një ceremoni mortore. Një gjë e tillë vërehet dukshëm nga pohimi i aktantit:

Mjeku: *S'di se kush e ka fillue grindjen, por pushkën e ka nisë Zeka. Ky ashtë çue në kaba, ka nxjerrë revolen dhe ka shti në atë që e thirrte vllath. Të dy i ka mbulue tymi, i kam pa të dy! Mandej ashtë dridhë toka.¹¹*

Camaj me vetëdije krijuese duket se ka zgjedhur disa pika - topika mjaft domethënëse dhe më përfaqësueset e shkandullimeve dhe shkeljeve që i janë bërë Kanunit, dokeve dhe zakoneve ndër malësor për të vu në pah degradimin, të larat dhe të pa larat e shkeljeve kanunore, si dhe degradimin e Ligjit dhe të Kanunit, kur ato përballen me njëri-tjetrin. Ai stigmatizon institucionin e dokeve, zakoneve - Kanunin, por edhe të ligjit siç vepron edhe Migjeni te *Molla e Ndalume*. Shkeljet dokësore që qëmton dhe shtjellon janë vrragët më të rënda dhe që marrin trajtën arketipave, më përfaqësuese, të cilat i shërbejnë për ngjizjen e ngjarjes dramatike, tashmë të ndërtuar nëpërmjet imagjinatës krijues, fiksionit.

Vrasjet në moh dhe me shtirje që bënë Zeka për të fsheh të vërtetën e zezonës së shkaktuara prej tij, me qëllim për të ruajtur një burrëri të shtirur sa për sy e për faqe, është një ngjarje tjetër që shtjellon më tej paburrërinë shtiracake - hipokrite të tij; një dukuri e tillë na shpërfaq karakterin e aktantit, vë në spikamë të keqen dhe ligësinë që mbart në vete qenia njerëzore. Kjo linjë rrëfimore i mëshon fort deheroizimit/shpërbërjes të figurës së malësorit dhe dokeve tashmë në përballje me ligjin dhe shoqërinë moderne. Një element i rëndësishëm i poetikës krijuese të Camajt në këtë vepër është pra edhe linja çmitizuese e figurës së malësorit kreshnik.

Linja e dashurisë mes Zekës dhe Bjeshkës në rinin e tyre, e cila në traditën malësore ndalohet dhe quhet kurvëri, është një shkelje/thyerje tjetër e dokeve dhe zakoneve sociokulturore të malësorit. Një gjë e tillë vihet re qartë në dialogun mes Bjeshkës dhe Mjekut, ku ky i fundit shprehet:

Mjeku: *Habitem që ka aq dhimbë për një gjaksor, Bjeshka. As e shoqja s'duhet të ket mëshirë për të! Shënon me gisht Bjeshkën. Qysh se ia kam ndëgjue tëparën herë zanin, thom, a asht e mundun që zani saj i përngjan aq fort zanit të asaj gruaje që bërtiste para pesëdhjetë vjetësh në zezonën e Përronit të Mbyllë: gjakësorë, lëshoni armët!¹²*

Çorganizimi i ligjeve të Kanunit, në momentin kur po vendosej ligji dhe ndërhynte institucioni shtetëror çoj në vëllavrasje. Autoriteti i shtetit duke qenë më i dobët se autoriteti i fisit e në të njëjtën kohë duke mos u vepruar sipas ligjësisë kanunore, vendosi në konflikt autoritetin e ligjit autoritetin e fisit, madje ky i

¹¹ M. Camaj, *Drama*. Vep. e cit., f. 92.

¹² M. Camaj, *Drama*. Vep. e cit., f. 96.

Elementet kanunore, vendi dhe funksioni – linja çmitizuese tek *Loja* ...

fundit u shndërrua në realitetin e ri të krijuar, në vetëgjyqësi sipas parimeve të pandehura të Knunit. Ai duke mos pasur interpretimin e duhur të pleqësisë dhe të parisë së fisit, njerëzit shpesh duke qenë të paafte për ta interpretuar dhe zbatuar, shfrytëzonin hapësirën e krijuar, madje me keqdashje nxitnin variante të shtrembëruara të tij, sigurisht edhe sipas dëshirës së më të fortit, i cili vetjaksonte zbatueshmërinë e tij.

Tek *Loja e mbasdrekës* autori - Gjormi shtron tezën se degjenerimi i Kanunit çon në zezonë. Duket qartë se një ndër kuptimet dhe mesazhet më kryesore që përcjell vepra është pikërisht ky:

Gjormi: teza ime është: degjenerimi i Kanunit çon në zezonë. Struktura e vjetër ligjore në kundërshtim me rendin e ri, apo zëvendësimi i vetëm i pjesës së Kanunit nga ligji ndërkombëtar kushtëzon zvetënimin e njërës apo të tjetrës ligje.¹³

Shumë studiues duke trajtuar këtë çështje mendojnë se janë ngutur kur anatemojnë Kanunin duke e emërtuar si primitiv, fatalist dhe nxitës të vëllavrasjes. Një gjë e tillë nuk lihet të kuptohet në tekstin dramatik të Camajt.

Vënia përballë e ligjit dhe e Kanunit evidenton paaftësinë e tyre për të vepruar, në një realitet të ri, ku nuk janë shuar ende reminishencat/ndikimet të strukturave të vjetra ligjore e ku ligji nuk është ende i aftë të veproj sipas klauzolave të tij. Institucioni i ndëshkimit në Kanu ka rënë, pra strukturat e vjetra ligjore në kohën kur ligji i shtetit po vendosej nuk janë më as të rendit të duhur e as funksionale, pra të afta të veprojnë dhe të krijojnë detyrime sanksionuese. Zeka dhe hijet e gjakësorëve të tjerë janë pikërisht pjellë e këtij sistemi jo funksional, në të cilin individ i ndjehet i kurthuar - mbyllur në një rreth vicioz pa rrugëdalje. Ky përfundim - konkluzion për ligjet edhe nga simbolika e togfjalëshit Përroni i Mbyllë. Pikërisht se individ është fajtorë edhe viktimë e një sistemi të tillë Zeka nuk dënohet prerazi - haptazi, në vepër:

Gjormi: Me vëndosmëni i dham dënimin në fund, jo Zekës, por hijeve të tan gjakësorëve përpara e mbas Përronit të Mbylltë. Zeka ta dha gurin e arrën në dorë sepse ai vetvetishëm, pa kullue punën gjatë, lypj prej teje prehjen e përjetshme, vdekjen, e ti këtë ia dhe pa përlye ndërgjegjen, petkun tand të zi.¹⁴

Autori - Gjormi - trupi gjykues i stisur është i pavendosur, në mëdyshje për vendimin që do të marrë ndaj Zekës, por ama në fund të veprës - në epilog ai dënon hijet e gjakësorëve, pra shoqërinë që ka ndërtuar një institucion i cili e korrupton individin e që nuk është e aftë të zbatojë ligjet e hartuara e të sanksionuara prej saj. Përball një rrethi vicioz (Përroni i Mbyllë) të sanksionuar dhe ndërtuar nga shoqëria dhe sistemi i ngritur prej saj, individ me nota sarkastike, në mënyrë absurde dhe fataliste kërkon prehjen, tragjikisht gjen shpëtim tek vdekja: “pa kullue punën gjatë, lypj prej teje prehjen e përjetshme, vdekjen, e ti këtë ia dhe pa përlye ndërgjegjen, petkun tand të zi”. Është shoqëria dhe institucioni i ligjit që kërkon ta shpallë fajtor e të hakmerret ndaj Zekës, megjithëse është po aq fajtorë sa ky i fundit, me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

¹³ M. Camaj, *Drama*, Vep. e cit., f. 50.

¹⁴ M. Camaj, *Drama*, Vep. e cit., f. 74.

Përballja i zbeh edhe ligjin edhe Knunin, në vepër stigmatizohen të dy për mos aftësinë veprues dhe zbatuese të normave dhe ligjësi të sanksionuara prej tyre si institucione të mbrojtjes së drejtësisë ndër njerëzore - shoqërore dhe individuale. Ligji në zonën prej kah vjen Camaj nuk pati mundur kurrë të sanksionoj autoritetin e tij siç duhet për të ndalur gjakmarrjet, madje mosveprimi dhe paaftësia e tij e kishte nxitur atë, siç ngjet me mësuesin tek novela *Gjaku* e Ernest Koliqit.

Degjenerimi i Kanunit dhe shkelja e normave morale bëhet aq e rrezikshme sa nuk njeh më asnjë lloj pengese kanunore apo ligjore qofshin ato:

Bjeshka: S'ka ma gjakmarrje këndeje, por shpagim. Në vend të vriten burrat e malësisë, i djejin arën anmikut të vet, natën për hanë.¹⁵

Mendojmë se nëse Camaj dënon/stigmatizon dikë a diçka ai nuk është Kanuni si element etnokulturor (sepse ai në krye të herës hartua për të ndal pikërisht vrasjet dhe zezonat që shkaktoheshin në një shoqëri ku mungonte ligji, morali dhe rregulli), por më së shumti dënon/stigmatizon institucionet, shkeljet, shtrembërimet për interesa të çastit - vetjake, shpërfilljet, shmangiet nga normat edhe të traditës qofshin ato, paftësinë e tyre dhe të shoqërisë për të vepruar për ballë tyre. Pra "dënon" shmangiet/thyerjet që i janë bërë nga shoqëria - hijet e gjakësorëve dhe Zeka si individ. Po kështu "dënon" artistikisht ligjin dhe institucionet shtetërore për paftësinë e tyre për të vendos pushtetin e tyre njëherë e mirë mbi një fenomen të tillë si ngjarja e Përrovi të Mbyllë.

Kështu të gjitha këto thyerje të rregullave kanunore, të dokeve dhe të zakoneve ndër më të shenjta për malësorët, të shpërfaqura e të shoklume përpara syve të publikut/lexuesit, i shërbejnë poetikës së Camajt si lëndë për brumosjen e tyre në trajta artistike. Tashmë ato nuk janë thjesht shkelje që iu kanë bërë Kanunit përgjatë shekujve, e prej të cilave kanë lindur zezona, rreshkata të pashoqe, por lëndë artistike, të cilat të bëjnë edhe të qeshësh, por edhe të qash, në tekstin dramatik të tij. Këto burime sociokulturore - dokësore janë përzgjedh e materializuar si objekt - trajtë letrare mjaft mirë, dhe me një mjeshtëri krijuese të veçantë për letërsinë shqipe, duke transfiguruar një realitet historik në një realitet - subjekt letrar.

Miti, legjenda, simboli, Kanuni me doket dhe zakonet e lashta ndeshen, përshkrihen, e njësohen me njëri-tjetrin, duke marrë trajta dhe sharme artistike si lëndë e letrarizuar në dramën *Loja e mbasderkës*. Çlirimet kategorizuese, duke e pagëzuar me lemën/konceptin lojë, dramën, tregojnë për guximin krijues të Camajt edhe në një gjini të tillë si dramaturgjia, për mjeshturin e rrallë dhe poetikën risuese dhe të ndërtuar përsëri origjinalisht në proceset krijuese. Në tekstet e tij ndeshemi me poetikën e çmitizimeve, poetikën e fshehjes së rrallë të kuptimeve në letërsinë shqipe, poetikën e esencave, poetikën estetizuese, poetikën e semantikës shumë planare të mbartjeve kuptimore, poetikën e sitës së rrallë të fjalëve duke i përzgjedhur mjeshtërisht ato, poetikën e simbolit dhe poetikën e shkategorizimeve - prishjes së tipologjisë së llojit si: dramë, tragjedi apo komedi.

¹⁵ M. Camaj, *Drama*, Vep. e cit., f. 21.

Elementet kanunore, vendi dhe funksioni – linja çmitizuese tek *Loja* ...

Në pak ose aspak poet apo shkrimtarë të letërsisë shqipe fjala dhe kumtet e sajë marrin aq polisemi kuptimore, aq aureola të reja semantike, aq fshehje kuptimore, aq përmbysje sintaksore se sa në penën mjeshtërore të tij. Pra, me pak fjalë Camaj është një personalitet i vendosur në hierarkinë e vlerave të letërsisë shqipe, i cili tashmë është i pashmangshëm si krijues me një individualitet të përveçuem. Çdo shkrim i dalë nga proceset krijues të tij është një risim brenda sistemit tonë letrar, një risi e ardhur në letërsinë shqipe dhe jo vetëm, sigurisht e ndërtuar mbi arketipat pararendës, por që kurrë nuk mbetet peng i tyre.

Bibliografi e shfrytëzuar

- A. Dhima, *Hyrje në Antropologji(botimi i tretë)*. Sh. Botuese “Press”, Tiranë 2010.
- A. Pipa, *Poezia dhe poetika e Camajt*. Në: revista letrare “Jeta e Re”, nr. 1-3, Prishtinë, 1996.
- Atë Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Shtypshkronja “GEER” Tiranë, 1999.
- D. Fo, *Çifti i hapur*, dorëshkrim.
- E. Fazhiu, *Kanunorja e lëvizjes Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare*, Prishtinë, 2008.
- E. Koliqi, *Arti i Martin Camajt*. Në: revista letrare “Jeta e Re”, nr. 1-3, Prishtinë, 1996.
- F. Hysa, *Teatrollogji, dramaturgji, regjiturë dhe aktrim, Antologji shkrimesh*. Sh. Botuese “Sythi”, Prishtinë.
- J. Papagjoni, *Kumti që vjen nga trashëgimia teatrore*. Sh. Botuese “Shkenca”, Tiranë, 1999.
- K. Velça, *Ç’më ka shkruar M. Camaj para se të vdiste*. “Shekulli”, Tiranë, 6 mars, 1999.
- L. Smaqi, *Loja si përballje mendësish e strukturash ne dramat e Camajt*. Në: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Tiranë, 2010.
- L. Kurti, *Drama apo tekste të dramatizuara*. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 2011.
- L. Memushi, *Antropologjia*, Sh. Botuese e “Librit Universitar”, Tiranë, 2004.
- M. Tirta, *Etnologjia e shqiptarëve*. Tiranë, 2000.
- M. Camaj, *Loja e Mbasdrekes*. Sh. Botuese “Onufri”, Tiranë, 2012.
- M. Prençi, *Një dramë moderne e ngritur mbi një tezë*. “Rilindje”, Tiranë, 18 mars 1998.
- N. Islami, *Historia dhe poetika e dramës shqiptare*. Sh. Botuese “ARTC”, Prishtinë, 2003.
- R. Kesing & A. Strathern. *Antropologjia kulturore (një perspektivë bashkëkohore)*, Sh. Botuese “UFO Press”, Tiranë, 2007.
- Sh. Sinani, *Camaj i paskajuar, rreth tipologjisë së llojeve në veprën e M. Camajt*. Shtypshkronja “KRISTALAINA-KH”, Tiranë, 2011.

